



▶ **INSTALOHET RRJETI I UJËSJELLËSIT NË KOMUNËN E RANILLUGUT**1

▶ **IMPLEMENTIMI I RREGULLORES PËR ZYRAT KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM NËPËR QEVERTË LOKAL**

▶ **QEVERIA E KOSOVËS DËSHMON PËRKUSHTIM NË INTEGRIMIN E PLOTË TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN**.....2

▶ **VAZHDIMËSI E BESUESHMËRISË SË KOMUNITETIT BOSHNJAK NË QËLLIMET E MIRA TË QEVERISË SË KOSOVËS DHE SHOQËRISË KOSOVARE NË PËRGJITHËSI** ...2



Republika e Kosovës – Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Zyra e Kryeministrit – Kancelarija premijera – Office of the Prime Minister
Zyra për Çështje të Komuniteteve / Kancelarija za pitanje zajednica / Office for Community Affairs

Fuqia në diversitet

INSTALOHET RRJETI I UJËSJELLËSIT NË KOMUNËN E RANILLUGUT

ZÇK vazhdon vizitat në teren për të siguruar implementimin e mirëfilltë të projektit të ujësjellësit dhe për të marrë opinionet e qytetarëve rreth këtij projekti



Komuna e Ranillugut, si komunë e re e krijuar nga procesi i decentralizimit është në zhvillim e sipër. Qeveria e Kosovës përmes Zyrës për Çështje të Komuniteteve, por edhe ministrive të linjës, ka ndarë fonde të konsiderueshme për të përmirësuar kushtet e jetesës për banorët e kësaj komune.

Ndër projektet e shumta që ZÇK i ka orientuar në këtë komunë është edhe projekti i ujësjellësit, duke i dhënë në këtë mënyrë një përgjigje përfundimtare problemeve të furnizimit me ujë të popullatës së kësaj komune.

Kjo dëshmon edhe njëherë përparësitë e institucioneve qeverisëse drejt ndërtimit të një infrastrukture bashkëkohore, furnizimit me ujë dhe rrjeteve të ujërave të zeza, dhe shkollave moderne me standarde të larta.

IMPLEMENTIMI I RREGULLORES PËR ZYRAT KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM NËPËR QEVERTË LOKALE



ZÇK vizitoi komunat e rajonit të Prishtinës për t'u njoftuar me të arriturat dhe punën e zyrave komunale për komunitete dhe kthim, si dhe implementimin e kësaj rregulloreje në përgjithësi.

Takimet u mbajtën me kryetarët dhe nënkryetarët e komunave, ku ata informuan rreth të arriturave dhe rezultateve, duke theksuar se këtë çështje e kanë marrë me shume seriozitet, ndërsa në disa nga komunat ky ri-formatizim veçse kishte përfunduar.

Në përgjithësi, puna në këtë drejtim, në rajonin e Prishtinës u vlerësua pozitive meqë shumica e komunave kishin zbatuar obligimet që dalin nga Rregullorja për zyrat komunale për komunitete dhe kthim.

Një pjesë të përgjegjësisë për monitorim të implementimit të Rregullore për zyrat komunale për komunitete dhe kthim e ka edhe Zyra për Çështje të Komuniteteve, që të sigurojë funksionalizimin e plotë të këtyre zyrave në nivel komunal. Unifikimi i zyrave lokale për komunitete dhe kthim, krijimi i mundësive për përfaqësim të të gjitha komuniteteve në nivel komunal dhe krijimi i mundësive që ata të vetëqeverisin është qëllimi themelor që ka Qeveria e Kosovës.

Adresa: Ndërtesa e Qeverisë; Sheshi Nëna Terezë p.n.

Tel: +381 /0/ 38 200 14 444

Email: zck-kpz@ks-gov.net

www.kryeministri-ks.net/zck/

QEVERIA E KOSOVËS DËSHMON PËRKUSHTIM NË INTEGRIMIN E PLOTË TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN

“Nothing about us without us” është deklaratë e vizionit dhe vlerave, e paraqitur nga përfaqësues të komunitetit rom të vendeve të ndryshme, organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertët e këtij komuniteti, në përcaktimin e objektivave dhe prioritetëve për Dekadën e përfshirjes së Romëve 2005-2015.

DECADE OF ROMA INCLUSION 2005-2015



Qeveria e Kosovës synon anëtarësimin e shtetit të Kosovës në Dekadën Rome, në mënyrë që të rrisë nivelin e bashkëpunimit me vendet e Evropës dhe shtetet fqinje në çështjet sociale, të edukimit, shëndetësisë dhe punësimit të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve. Kjo nismë fillimisht ishte përkrahur fuqishëm nga Sekretariati Koordinues i Dekadës Rome, me seli në Budapest.

Si rrjedhojë e kësaj, me ftesë të Këshillit të Qeverisë së Çekisë për Çështje të Pakicave Rome, më 28 shtator të këtij viti, një delegacion qeveritar i kryesuar nga Ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Sasa Rasic, dhe këshilltari i lartë i Kryeministrit dhe drejtori i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, Srdjan Sentic, udhëtuan për Pragë, për të marrë pjesë në takimin e radhës së Komitetit Ndërkombëtar Drejtues, të organizuar nga Republika e Çekisë.

Qëllimi i vizitës është informimi mbi rrjedhat, procedurat dhe mundësinë e anëtarësimit sa më të shpejtë të Kosovës në Dekadën Rome 2005-2015.

Institucionet e Kosovës janë të angazhuara për integrimin e plotë të komuniteteve RAE në shoqërinë kosovare duke zbatuar një politikë për strehimin, punësimin dhe shkollimin e pjesëtarëve të tyre, përmes ndarjes së fondeve për projekte që nxisin integrimin e tyre në shoqëri dhe promovimin e identitetit dhe kulturës së këtyre komuniteteve.

Kosova synon anëtarësimin në Dekadën Rome, si një forum i përbashkët i vendeve të Evropës dhe Ballkanit, që shërben për shkëmbim e praktikave më të mira dhe futjen e nismave të reja për stabilizimin e romëve dhe krijimin e kushteve adekuate për një jetë sa më të mirë.



DEKADA E PËRFSHIRJES SË ROMËVE 2005-2015 PRESIDENCA E REPUBLIKËS SË ÇEKISË

Deklaratë rreth situatës së Romëve në Evropë
Komiteti Drejtues Ndërkombëtar
Dekada e Përfshirjes së Romëve 2005-2015

Pragë, 1 tetor 2010

Komiteti i 19-të Drejtues Ndërkombëtar i Dekadës së Përfshirjes së Romëve 2005-2015, ka ardhur në një përfundim të përbashkët, që kohët e fundit ka pasur një përkeqësim të rrezikshëm të situatës së Romëve në Evropë.

Përrjashtimi social, e në disa raste edhe shkelja të drejtave të njeriut, i bëjnë Romët njerëzit më të varfër dhe më të cenusur në Evropë. Qëndrimet diskriminuese ndaj Romëve, në kombinim me pasojat e politikave që kanë në fokus sigurinë dhe ushtrimin e krizës ekonomike, i vendosin Romët në një pozitë jashtëzakonisht të pafavorshme. Romët shpesh janë viktimë e fushatave të masës, të nxitura nga organizatat ekstremiste. Nëse nuk ekziston një rritje e mbështetjes sonë të përbashkët për përfshirjen e Romëve dhe luftimi i shkeljeve të drejtave njerëzore, pa një kërkim intensiv për instrumente të reja për të ndihmuar përfshirjen e Romëve, ekziston rreziku që problemi të shkallëzohet në nivele edhe më të rrezikshme.

Ne duhet ta ndalim menjëherë retorikën e stigmatizimit, ta fuqizojmë dhe ta bëjmë më efektiv bashkëpunimin në mes të vendeve të Evropës, në interes të përmirësimit të situatës së Romëve në Evropë.

Pra, Komiteti Drejtues Ndërkombëtar i Dekadës së Përfshirjes së Romëve iu bën thirrje të gjitha vendeve Evropiane që të përforcojnë thelbin e misionit të Dekadës së Përfshirjes së Romëve:

-Eliminimi i diskriminimit dhe mbyllja e vrimave të papranueshme në mes të Romëve dhe pjesëtjetër të shoqërisë;

-Të rritet bashkëpunimi dhe të sigurohen sinergjitë në mes të vendeve Evropiane dhe në mes të institucioneve ndërkombëtare dhe Evropiane, brenda platformave ekzistuese duke i pasur parasysh parimet themelore të BE-së për përfshirjen e Romëve;

- Të mbështetet obligimi i tyre drejt mbrojtjes dhe realizimit të drejtave themelore dhe të shmangen masat dhe deklaratat që diskriminojnë komunitetin romë.

Komiteti Drejtues Ndërkombëtar udhëzon presidencën Çeke që të zgjerojë ftesën tek të gjitha vendet Evropiane për t'iu bashkangjitur Dekadës së Përfshirjes së Romëve.

VAZHDIMËSI E BESUESHMËRISË SË KOMUNITETIT BOSHNIJAK NË QËLLIMET E MIRA TË QEVERISË SË KOSOVËS DHE SHOQËRISË KOSOVARE NË PËRGJITHËSI

Kjo u tha në shënimin e Ditës së Boshnjakëve më 28 shtator, në manifestimin e organizuar nga Unioni i Bashkuar i Boshnjakëve dhe pjesëtarët e komunitetit boshnjak të Kosovës. Ky manifestim i pasur me program kulturor-artistik zgjati tri ditë dhe u bashkë-financua nga Qeveria e Kosovës.



Për të festuar 28 shtatorin-Ditën Ndërkombëtare të Boshnjakëve të Kosovës, përfaqësues nga Zyra për Çështje të Komuniteteve morën pjesë në Akademinë Solemne që u mbajt në Prizren, manifestim ky në të cilin përfaqësuesit e komunitetit boshnjakë paraqiten shqetësimet por edhe të arriturat e komunitetit boshnjak në shtetin e Kosovës.

Këtë ditë të shënuar e pasuruan edhe aktivitete teatrale të shumta që e bënë manifestimin edhe më madhështor.



Manifestim filloi me hapjen e Festivalit të Sarajevës në Prizren më 27 shtator, ku u shfaqën filma dokumentarë dhe artistik.

Njëkohësisht u ekspozuan punime dore dhe piktura, fotografi dhe ekzemplarë etnologjike të cilat për së afërmi paraqesin një kulturë dhe traditë ndër shekuj të komunitetit boshnjak.

Shtëpitë botuese paraqitën botimet e tyre për tri ditë radhazi, ndërkaq me 28 shtator shoqëritë kulturore-artistike të boshnjakëve defiluan në qytet. Ky manifestim zgjati edhe me 29 shtator, për të shënuar kështu një përfundim të suksesshëm dhe një solidarizim në mes të komunitetit boshnjak të të gjitha vendeve fqinje.

Në këtë shënim të Ditës së Boshnjakëve u prezantuan edhe punime të cilat më parë ishin financuar si projekte të veçanta të cilat bëjnë promovimin e kulturës dhe traditës së komunitetit boshnjak që jetojnë në trevat e ndryshme të Kosovës. Kjo njëkohësisht përforcon bashkëpunimin e ZÇK-së me të gjitha komunitetet pa dallim.



GATISHMËRIA E INSTITUCIONEVE SHTETËRORE PËR QASJE DHE PËRDORIM TË DREJTË TË GJUHËVE ZYRTARE NË KOSOVË

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet ekzistuese në Kosovë kanë një nivel të avancuar të dispozitave ligjore për përdorimin e gjuhëve zyrtare, por në përgjithësi është shqetësues fakti se sa ato zbatohen në praktikë!

Kjo bëri që kohë më parë ZÇK filloi të merret me hulumtimin e politikave të përdorimit të gjuhëve zyrtare në institucionet qendrore dhe lokale të të gjitha niveleve. Kjo është vazhdimësi e angazhimeve të Zyrës për Çështje të Komuniteteve për të siguruar që zhvillimi i politikave dhe legjislacionit i respekton dhe promovon të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Ky studim synon të ofrojë një pasqyrë të saktë të përdorimit të gjuhëve zyrtare në institucionet kosovare dhe të vlerësojë nivelin e zbatimit të dispozitave legjislative në fuqi.

Gjatë muajit tetor ZÇK planifikon të mbajë gjashtë punëtori, ku para strukturave lokale përfshirë këtu edhe përfaqësues të të gjitha komuniteteve, do të paraqesë rëndësinë e këtij studimi të politikave, si dhe rolin dhe mandatin që luan ZÇK në implementimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve



Zyra për Çështje të Komuniteteve angazhohet për ngritjen dhe vetëdijësimin e opinionit publik duke ofruar informata rreth çështjeve të komuniteteve në përgjithësi. Aktualisht kjo zyrë është në përgatitje të tryezave të rrumbullakëta që synojnë angazhimin e një dialogu mbi zbatimin e dispozitave ligjore, që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve dhe efektivitetin e tyre

në integrimin e të gjitha komuniteteve dhe ruajtjen e gjuhëve të tyre.

Është paraparë që këto punëtori të mbahen në të gjitha regjionet e Kosovës. Konkluzionet e diskutimeve do të mundësojnë në hartimin e një raporti të plotë dhe zhvillimin e rekomandimeve të



mjaftueshme për të përmirësuar efikasitetin e politikave gjuhësore.